

URDHËR
Nr. 144, datë 21.7. 2016

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushte-tutës, së Republikës së Shqipërisë, të shkronjës “d”, të nenit 28, të ligjit nr. 9000, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Mjedisit, drejtorit të përgjithshëm të Mjedisit dhe Jetësimit të Prioriteteve z. Pëllumb Abeshi, të drejtën e firmosjes së autorizimeve, ankimeve, rekurseve dhe të gjitha akteve shkresore drejtuar gjykatës, në çdo shkallë të gjyqimit.

2. Kompetencat e titullarit të Ministrisë së Mjedisit do të ushtrohen për periudhën nga data 1.8.2016 deri më 10.08.2016.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet drejtori i përgjithshëm i Mjedisit dhe Jetësimit të Prioriteteve z. Pëllumb Abeshi.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MJEDISIT
Lefter Koka